



Pranuar / Received Prisporočen / Delivered	16.12.2021	2021	1	vit god year
Organ / Organizacija Org / Inst	Dr. Prof. Dr. Prof. Post. No.	Shkëlqim Prilog Appendix	Sasia Kopësira Quantity	
SKINMSHOC	G203/2021		1/7	

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.874/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.874/2021 të datës 20.10.2021, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi rr. "Yll Morina" H3/1 në Komunën e Gjakovës, kundër Vendimit me numër RAN0000710 të datës 23.09.2021 të Zyrës së Personelit të Komunës së Gjakovës „në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.874/2021 e datës 20.10.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër RAN0000710 të datës 23.09.2021 të Zyrës së Personelit të Komunës së Gjakovës.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 31.07.2021 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 23.08.2021 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialist i administrimit të përgjithshëm lidhur me pozitat “Zyrtar për gjendje civile1”, “Zyrtar për arkiv2” dhe “Zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme “ Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile.

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja. Kryetari i Komunës së Gjakovës me datën 01.09.2021 ka nxjerr Vendimin me Nr.01-112/02-25168 për themelimin e Komisionit ad-hoc me tre anëtar, për vlerësimin e procedurës së rekrutimit për emrin e grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm. Menaxheri i Personelit i Komunës së Gjakovës me datën 17.09.2021 ka nxjerrë Vendimin me numër RAN0000710, sipas të cilit

ankuesja eshte njoftuar se nuk eshte pelishte ne listen e ngushte, ne konkursin per grupin Specialist i administrimit te pergjithshem, me arsyetimin se i mungon pervoja profesionale e punes prej se paku dy (2) vite pervojë pune profesionale.

Kundër vendimit për mos përfshirjen në listën e ngushtë të datës 17.09.2021, ankuesja ka parashtruar ankesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës. Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Gjakovës me datën 23.09.2021 ka nxjerrë Vendimin me numër RAN0000710 sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm.

Ankuesja kundër Vendimit me numër RN0000710 të datës 23.09.2021, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Postës së Kosovës me datën 18.10.2021 ka dorëzuar ankesën me numër të protokollit 5099/2021, e cila është pranuar me datën 20.10.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për mos përfshirje në listën e ngushtë nga ana e Njesisë së Personelit në Komunën e Gjakovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:5099/2021 të datës 20.10.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë e ankueses dërguar Njesisë për menaxhimin e burimeve njerëzore të Komunës së Gjakovës; Përgjigje në ankesë e datës 23.09.2021 nga Menaxheri i burimeve njerëzore të Komunës së Gjakovës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 25.10.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 09.11.2021 nga Komuna e Gjakovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkurs i datës 23.08.2021 për pozitën e grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Vendim i datës 01.09.2021 për themelimin e komisionit të pranimit në shërbimin civil; Lista me kandidatët të cilët janë përfshirë në listën e shkurtë e datës 17.09.2021; Vendim i datës 14.09.2021 lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankueses për listën e shkurtër; Vendim i datës 23.09.2021 nga njësia e burimeve njerëzore për ankuesen; Lista me rezultatet përfundimtare të verifikimit paraprak të kandidatëve e datës 24.09.2021; Lista me renditjen përfundimtare të kandidatëve e datës 13.10.2021; Rezultatet përfundimtare të vlerësimit nga grupi Specialist i Administrimit të Përgjithshëm i datës 22.10.2021; Aplikacioni për punësim i datës 03.09.2021 i kandidatit _____ së bashku me dokumentet e bashkangjitura mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës _____ i kandidatës _____ se bashku me dokumentet e bashkangjitura mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 03.09.2021 i kandidatit _____ së bashku me dokumentet e bashkangjitura mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 01.09.2021 i kandidatit _____ se bashku me dokumentet e bashkangjitura mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 27.08.2021 i kandidatës _____ së bashku me dokumentet e bashkangjitura mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 03.09.2021 i kandidatës _____ së bashku me dokumentet e bashkangjitura mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 04.09.2021 i kandidatës _____ së bashku me dokumentet e bashkangjitura mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i

punësim i datës 27.08.2021 i kandidatit së bashku me dokumentet mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 27.08.2021 i kandidatës së bashku me dokumentet mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 24.08.2021 i kandidatës së bashku me dokumentet mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 06.09.2021 i kandidatit së bashku me dokumentet mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 30.08.2021 i kandidatës së bashku me dokumentet mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 31.08.2021 i kandidatës së bashku me dokumentet mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 04.09.2021 i kandidatës së bashku me dokumentet mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 25.08.2021 i kandidatës së bashku me dokumentet mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 06.09.2021 i kandidatës së bashku me dokumentet mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 03.09.2021 i kandidatës së bashku me dokumentet mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 03.09.2021 i kandidatës së bashku me dokumentet mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 06.09.2021 i kandidatës së bashku me dokumentet mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 03.09.2021 i kandidatit së bashku me dokumentet mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 24.08.2021 i kandidatës së bashku me dokumentet mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 27.08.2021 i kandidatës së bashku me dokumentet mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Testet me shkrim të datës 30.09.2021 për kandidatët aplikues; Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër VK.nr.61/2021 i datës 03.12.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses është e pabazuar, *sepse:*

Sipas shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se Komuna e Gjakovës me datën 23.08.2021 ka shpallur konkursin e jashtëm për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm lidhur me pozitat "Zyrtar për Gjendje Civile1", "Zyrtar për Arkiv 2" dhe "Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme". Ankuesja, ka aplikuar në këtë konkurs të datës 23.08.2021, ndërsa me datë 17.09.2021 Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës, në fazën e verifikimit paraprak të dokumentacionit, ka nxjerr Vendim për refuzimin e aplikacionit të ankueses mbi bazën se ankueses i mungon përvoja e punës pas diplomimit e që sipas konkursit në fjalë është se paku dy (2) vite.

E pakënaqur me vendimin mbi refuzimin e aplikacionit, ankuesja ka parashtruar ankesën në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës. Ky i fundit përmes Vendimit me numër RAN0000710 të datës 23.09.2021 e ka refuzuar ankesën e ankueses lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës të ofruara nga organi i punësimit dhe ankuesja ka konstatuar se kriteret e konkursit për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm, kanë qenë si në vijim :

- *Diplomë të studimeve universitare në Ekonomi, Biznes, Juridik, Edukim ose Administraë Publike me të paktën 180 kredit/ECTS apo ekuivalente me to.*
- *Së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor të ankueses se e njëjta ka poseduar përvojën e punës për pozitën në fjalë, Kolegji nga analizimi i dosjes së aplikimit të ankueses dhe organi i punësimit ka gjetur se ankuesja me rastin e aplikimit për këtë pozitë si dëshmi të kualifikimit shkollor dhe përgatitjes së përvojës së punës posedon Diplomë Universitare me numer 2780 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me datë 16.09.2014 me të cilën dëshmohet se ka kryer Fakultetin Juridik me datë 02.06.2011 dhe mori titullin Jurist i diplomuar si dhe me përvojë të punës sipas Vërtetimit me numër 01 Nr.112-78/2017 të datës 19.05.2017 të lëshuar nga Zyra e Personelit e Komunës së Gjakovës, me të cilën vërtetohet se ankuesja ka përfunduar punën praktike dhe profesionale pranë Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative-Sektori i gjendjes civile për periudhën nga data 01.08.2014-30.10.2015 (3) muaj pune praktike pranë Sektorit për Gjendje Civile, nga data 01.07.2015-30.09.2015 (3) muaj pune profesionale pranë Sektorit të Gjendjes Civile sipas marrëveshjes mbi shërbime të veçanta nr.01/112-43571, nga data 07.10.2015-31.12.2015 (3) muaj pune profesionale pranë Sektorit për Gjendje Civile sipas marrëveshjes mbi shërbime të veçanta nr.01/112-71363 si dhe nga data 21.06.2016-21.09.2016 (3) muaj pune profesionale pranë Sektorit për Gjendje Civile sipas marrëveshjes mbi shërbime të veçanta nr.01/112-32715, po ashtu vërtetimin me numër Nr.01/112-185 i datës 29.11.2017 të lëshuar nga Zyra e Personelit e Komunës së Gjakovës me të cilin dëshmohet se ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune në pozitën "Zyrtar për Gjendje Civile" në kuadër të Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative nga data 10.07.2017-10.11.2017 (4) muaj në Komunën e Gjakovës, si dhe nga data 17.06.2013-16.12.2013 në vijimin e praktikës profesionale në kuadër të "Projekti i tregut aktiv të punësimit për të rinjtë" nga avokat në Gjakovë, e që të gjitha këto nuk e arrijnë përvojën e punës prej dy (2) vitesh pas diplomimit, ashtu siç është kërkuar me konkurs.

Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Gjakovës bazuar në kriteret e konkursit po ashtu edhe dëshmitë e bashkangjitura nga ankuesja, në pajtim me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka bërë vlerësimin paraprak nëse kandidatët kanë plotësuar kushtet e konkursit, rrjedhimisht në bazë të kësaj ankuesja me vendim është njoftuar që nuk ka plotësuar kushtet e konkursit me arsyetimin që i mungon përvoja profesionale e punës, ngase në konkurs është kërkuar së paku 2 (dy) vite përvojë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, janë përcaktuar kriteret për secilën kategori të shërbimit civil, konkretisht pozita në grupin Specialist i Administrimit

të Përgjithshëm, hyn në kategorinë e nivelit profesional 2, ku tek shtojca Nr. 1/9 pika IV e kësaj rregulloreje tek karakteristikat e përgjithshme formale-respektivisht tek përvoja e punës theksohet: *Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës*, në këtë rast meqenëse ankuesja, nuk ka ofruar dëshmi që posedon dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës siç kërkohet në konkurs, atëherë sipas dispozitave ligjore në fuqi e njëjta edhe nuk i ka plotësuar kushtet e përcaktuara të konkursit, andaj, duke marr parasysh konstatimin si me lartë, Kolegji vlerëson se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Gjakovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër RAN0000710 të datës 17.09.2021 me të cilin ka refuzuar aplikacionin e ankueses për shkak të mos përmbushjes së (2)vjet të përvojës së punës pas diplomimit dhe Vendimit me numër RAN0000710 të datës 23.09.2021 për refuzimin e ankesës të ankueses, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me nenin 15 paragrafi 1, 2, dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak..5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimit..* ndërlidhur me nenin 34 paragrafi 6 nen paragrafi 6.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe shtojcën Nr. 1/ pika IV të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, andaj edhe pretendimi i ankueses që e njëjta i ka plotësuar kushtet e konkursit sa i përket përvojës së punës është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses lidhur me atë se pozita "Zyrtar për evidentimin e pronave të paluajtshme" është pozitë në Sektor të Tatimit në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa e jo në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme, ka konstatuar se pozitat "Zyrtar për gjendje civile 1", "Zyrtar për arkiv 2" dhe "Zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme", janë shpallur të gjitha me një konkurs me emrin e grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm gjë e cila i ka përfshirë si tërësi tri drejtoritë në Komunën e Gjakovës e që të gjitha kanë të bëjnë me ushtrimin e përgjegjësive të përgjithshme administrative që përfshijnë menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin financiar, menaxhimin e përgjithshëm (të pronave, të pasurisë, teknologjisë informative, logjistikës), si dhe të funksioneve të tjera të ngjashme mbështetëse, që bëjnë të mundur funksionimin normal të institucioneve.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses lidhur me përfshirjen në listë të ngushtë të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar kriterin e përvojës së punës, ka konstatuar se ky pretendim është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar sepse në baze të dëshmive të ofruara për përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës të bashkangjitura në dosjet e kandidatëve të cilët kanë aplikuar në këtë konkurs të ofruara nga organi i punësimit ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Gjakovës me rastin e verifikimit paraprak të dosjeve të kandidatëve respektivisht plotësimin të kriterëve të përgjithshme dhe ato të veçanta si dhe me rastin e përpilimit të listës së ngushtë të datës 17.09.2021 ka vepruar në pajtim me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. s


Andaj pas gjithë këtyre fakteve të lartëcekura, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me numër RAN0000710 i datës 23.09.2021 i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës, është nxjerrë në përputhje me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me nenin 15 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe juridike.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.874/2021

Ardita Perçuku-Shyti


Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuese
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së,

